

*Përgjegjës/Sektori i Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141 datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 233, datë 20.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës/Sektori i Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Drejton të gjithë punën e sektorit dhe përgjigjet për cilësinë e saj, pranë drejtorit të drejtorisë përkatëse;
- Kontrollon dokumentimin dhe implementimin e masave minimale të sigurisë teknike dhe organizative, nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;
- Kontribuon në hartimin e Raporteve të Kontrollit të Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të informacionit dhe kontrollon zbatimin e masave dhe rekomandimeve sipas Raportit të Kontrollit;
- Përgatit, harton rekomandime për mirëqeverisjen e sigurisë kibernetike të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit;
- Mbikëqyr zbatimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planit të veprimit, si dhe harton raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit nga të gjitha institucionet përgjegjëse;
- Realizon trajnimet me OIRI dhe OIKI, si dhe institucionet përgjegjëse, për sigurinë kibernetike.

#### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

**Arsimi:** Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Shkenca (Juridike, Ekonomike, Informatike, Kompjuterike, Elektrike). Edhe diploma “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë.

**Përvoja:** Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion. Përbën avantazh eksperiencë e punës në fushën e kontrollit të sigurisë kibernetike/teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturave të çelësive publik (PKI).

## **FUSHA E NJOHURIVE:**

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Legjislacionin e sigurisë kibernetike;
- Legjislacionin mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;
- ISO 27001:2013

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Përparësi certifikime profesionale të fushës si: ISO 27001:2013 ‘Lead Auditor’; CISA, CISSP; ‘Cyber Intelligence’, ‘Information System Auditing’; ‘Conformity Assessment Body–eIDAS Regulation (EU) 910/2014’; ‘International LaW of Cyber Operation’; CompTIA Security+;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III-1)**

## **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.11.2024, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@aksk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@aksk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.